

A photograph of two young children in a classroom. The child on the left is a girl with dark hair, wearing a white school uniform and a light blue surgical mask. She is sitting on a blue chair. The child on the right is a boy with dark hair, wearing a red t-shirt and a colorful patterned face mask. He is sitting on the floor. In the background, there is a green chalkboard with some faint writing, a red bulletin board with a calendar, and a poster titled 'Count by 2's' with colorful numbers. The scene is lit with soft, natural light.

Manual

SI TË PARANDALOJMË
EKSTREMIZMIN E
DHUNSHEM??

“ SI TË PARANDALOJMË EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM ”

Manuali “Si të parandalojmë ekstremizmin e dhunshëm” është përgatitur nga Instituti ADRIAPOL në kuadër të projektit “Parandalimi dhe riintegrimi i sigurt: Një qasje holistike dhe qëndrueshme ndaj ekstremizmit të dhunshëm” zbatuar nga **Instituti Adriapol dhe Terre Des Hommes Shqipëri**, në partneritet me **Qendrën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri (CVE)** me mbështetjen financiare të **Fondit Global Të Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit (GCERF)**.

Pikëpamjet dhe informacionet e dhëna në këtë dokument janë vetëm të autorëve dhe jo domosdoshmërisht shprehin pikëpamjet dhe qëndrimet e donatorit.



TABELA E PËRMBAJTJES



3

Fjalorth

4

Hyrje

5

Rreth ekstremizmit të dhunshëm

9

**Edukimi i të rinjve strategji
parandaluese kundër
ekstremizimit të dhunshëm**

13

**Mbështetje për fëmijët dhe të
rinjtë e rikthyer nga zonat e
konfliktit**

17

Informacion

19

Referenca

FJALORTH

RADIKALIZMI

Radikalizimi i dhunshëm është kur një person beson se për të përmbushur një ide ose një synim që është i rëndësishëm për të, ai/ajo ka të drejtë të nxisë ose të përdorë dhunën për të imponuar atë ide.

EKSTREMIZËM

Nënkupton “besimin dhe mbështetjen në idetë që janë shumë larg nga ato që shumica e njerëzve i konsiderojnë të sakta ose të arsyeshme”. Kështu, "ekstremizmi" i referohet qëndrimeve ose sjelljeve që konsiderohen jashtë normës.

EKSTREMIZMI I DHUNSHËM

Ekstremizimi i dhunshëm është kur një person mbështet dhe mbron mendime ekstreme që janë në kundërshtim me interesat më të mira të komunitetit në tërësi. Në shumë raste, persona të tillë nxisin ose përdorin dhunën për të imponuar idetë e tyre.

TERRORIZMI

Terrorizimi është një akt i krijimit të frikës nëpërmjet përdorimit të dhunës duke sulmuar mënyrën e jetës dhe liritë e njerëzve të pafajshëm për të imponuar ide dhe besime ekstreme.

FAKTORË SHTYTËS

Kushte që mund të nxisin qytetarët drejt ekstremizmit të dhunshëm, të tillë si: përjashtimi, pabarazia, diskriminimi, persekutimi ose perceptimi i persekutimit, mundësia e kufizuar për arsimim të përshtatshëm dhe cilësor, mohimi i të drejtave dhe lirive civile, si dhe për arsye të tjera mjedisore, historike dhe social-ekonomike.

FAKTORË TËRHEQËS

Përfitimet personale që qytetarët mendojnë se mund të sigurojnë nëpërmjet pjesëmarrjes në grupe ekstremiste, siç janë: dëshira për aventurë dhe famë, plotësim i boshllëkut shpirtëror, fuqizim qytetar si pjesë e klanit, kushte më të mira jetese (grupet ekstremiste ofrojnë shërbime/të ardhura në këmbim të anëtarësimit).

Hyrje

Gjatë dy dekadave të fundit ekstremizmi i dhunshëm në të gjitha format e shfaqet e tij ka qënë një kërcënim serioz për paqen dhe sigurinë në mbarë botën. Përpjekjet për ta parandaluar dhe luftuar atë janë kthyer në një nga prioritetet kryesore të politikave dhe praktikave në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Duke marrë parasysh që procesi i riatdhesimit dhe riintegritit të shtetasve shqiptarë nga zonat e konfliktit, ka filluar, është me rëndësi të vazhdoen përpjekjet intensive për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në rang vendi.

Arsimi, si në mjedise formale ashtu edhe në ato joformale, vazhdon të jetë një komponentë kritik në luftën kundër këtij fenomeni. Fëmijët dhe të rinjtë si një nga target grupet më potencialisht të rrezikuar duhet të pajisen me njohuri dhe aftësi për të kuptuar dhe refuzuar këtë lloj kërcërimi. Ata duhet të mbështeten dhe orientohen të kuptojnë se ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi nuk janë rruga e duhur për zgjidhjen e padrejtësive dhe konflikteve me të cilat përballen dhe/ ose identifikojnë veten e tyre.

Referuar këtij konteksti ky manual do të përdoret si mjet për rritjen e ndërgjegjësimit të drejtuesve arsimorë, mësuesve, punonjësve të shërbimit psiko-social etj.,



për ti ndihmuar të njohur faktorët kryesorë që shtynë të rinjtë drejt ekstremizmit të dhunshëm, identifikuar ato aspekte të edukimit të cilave ju duhet kushtuar më shumë vëmendje në punën me ta dhe për ti kthyer mjediset arsimore në hapësira të sigurta ku të rinjtë mund të diskutojnë, ndajnë dilema, shqetësime si edhe zhvillojnë të menduarit kritik.

Më konkretisht, ky manual synon të:

- Japë një panoramë të qartë të ekstremizmit të dhunshëm dhe faktorëve të tij nxitës.

- Ndhimojë drejtuesit arsimorë, mësuesit, stafin psiko-social të sistemit parauniversitar të kuptojnë rolin e tyre dhe rëndësinë e programeve edukuese për të ndihmuar të rinjtë ti rezistojnë propagandës së ekstremizimit të dhunshëm dhe mbështetur procesin e riintegritit të fëmijëve/ të rinjve të rikthyer nga zonat e konfliktit.



Të kuptojmë ekstremizmin e dhunshëm

Për “ekstremizmin e dhunshëm” qarkullojnë një sërë përkufizimesh të cilat janë zhvilluar për t’ju shërbyer qëllimeve të ndryshme dhe nuk kanë qenë gjithmonë të harmonizuara.

Një nga përkufizimet më të pranuar pohon se “ekstremizmi i dhunshëm [1]” i referohet veprave të dhunës që përligjen ose shoqërohen me një ideologji ekstremiste fetare, sociale apo politike. Koncepti i ekstremizmit të dhunshëm është më i gjerë dhe më i shtrirë se sa terrorizmi, sepse ai mirëpret çdo lloj dhune, për sa kohë që motivimi i tij gjykohet si ekstremist.

Pikëpamjet e ekstremizmit të dhunshëm mund të shfaqen në një sërë çështjesh, duke përfshirë dhe marrëdhëniet politike, fetare dhe gjinore. Asnjë shoqëri apo komunitet nuk është imun ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Ekstremizmi i dhunshëm [2] cilësohet situata kur: “Individi nuk pranon pikëpamje të ndryshme nga të vetat; kur mendon se pikëpamjet e veta janë të veçanta, kur nuk pranon mundësinë e të ndryshmes duke tentuar ti imponojë mendimet e veta të tjerëve, nëse është e nevojshme, edhe përmes dhunës”.

“Radikalizimi [3]” sipas OSCE (2020) u referohet proceseve me anë të të cilave individi përqafton apo mbështet gjithmonë e më shumë ide që konsiderohen të jenë ekstremiste. Në mënyrë tipike, radikalizimi nuk shkaktohet nga një ndikim i vetëm, por nga një ndërthurje faktorësh dhe dinamikash. Ai është një koncept me interpretime të ndryshme.

[1] OSCE (2020). Rehabilitimi dhe riintegrimi jashtë kontekstit të burgut për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çojnë në terrorizëm – Udhëzësues për politikëbërësit dhe ofruesit e shërbimeve në Evropën Juglindore. E aksesueshme online në: <https://www.osce.org/files/f/documents/b/0/467055.pdf>

[1] UNESCO (2016). A teacher's Guide on the Prevention of Violent Extremism. E aksesueshme online në: https://en.unesco.org/sites/default/files/lala_0.pdf

[1] OSCE (2020). Rehabilitimi dhe riintegrimi jashtë kontekstit të burgut për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çojnë në terrorizëm – Udhëzësues për politikëbërësit dhe ofruesit e shërbimeve në Evropën Juglindore. E aksesueshme online në: <https://www.osce.org/files/f/documents/b/0/467055.pdf>

Shpesh termi përdoret në një mënyrë që sugjeron një lidhje të nënkuptuar midis ideve radikale dhe dhunës. Kjo është problematike sepse jo të gjithë ata që kanë ide radikale (apo ekstremiste) do të angazhohen apo do të mbështesin veprime të dhunshme, dhe se mundësia për të pasur ide - pavarësisht nga natyra e tyre - është e përcaktuar si një e drejtë themelore e njeriut.



Faktorët që çojnë drejt ekstremizimit të dhunshëm

Dukuritë e ndërlikuara si ekstremizmi i dhunshëm, është e qartë se nuk mund të kenë vetëm një shkak apo faktor nxitës. Janë identifikuar të paktën 8 grupe faktorësh që mund të nxisin individët, në mënyrë të veçantë të rinjtë drejt ekstremizmit të dhunshëm:

» Faktorët individualë

Në këtë grup faktorësh përfshihen të gjitha pakënaqësitë dhe emocionet individuale të tilla si: tjetërsimi dhe përjashtimi; zemërimi dhe zhgënjimi; përjetimi i një ndjenjë të fortë padrejtësie mbi atë që ndodh përreth; ndjenja e poshtërit; tendenca për të keqinterpretuar situatat; teoritë konspirative; ndjenja e viktimizimit; dobësitë personale; elementet kundërkulturore etj.

» Faktorët socialë dhe ekonomik

Këtu përfshihen faktorë të tillë si: përjashtimi social; marginalizimi dhe diskriminimi (i vërtetë ose i perceptuar); lëvizshmëria e kufizuar; niveli i arsimimit; përfshirja në tregun e punës; zhvendosja nga një vend tek tjetri; kriminaliteti; mungesa e kohezionit social dhe vetëpërjashtimi.

» Faktorët politikë

Në këtë grup përfshihen faktorët “ne dhe ata”. Individu portretizon forcën politike dominuese si pushtuese të identitetit, duke përjetuar kështu ndjenja të forta padrejtësie dhe zemërimi që e shtyn ta perceptojë botën si të ndarë në dysh (njëra anë që kërkon mbrojtje/ sakrificë për mbijetesë dhe ana tjetër e ngarkuar me stereotipa dhe paragjykime negative).

» Faktorët ideologjikë/fetarë

Këtu përfshihen rrëfimet historike që konsiderohen të shenjta. Shembujt tregojnë për krime të kryera në emër të krishtërimit apo Islamit, duke predikuar mbrojtjen e besimit nga mëkati i vdekshëm dhe imoraliteti.

» Krizat kulturore dhe të identitetit

Ky grup faktorësh ka lidhje me margjinalizimin kulturor, i cili çon në tjetërsim të perceptuar dhe një ndjenjë të fortë mungese përkatësisë ndaj vendlindjes apo shoqërisë ku individit jeton. Këta individë e kanë të vështirë të integrohen dhe për këtë arsye ndjejnë se janë “ndryshe” dhe si rrjedhim margjinalizohen nga të tjerët. Tjetërsimi dhe ndjenja e padrejtësisë që ndjen individit janë pikërisht burimet kryesore që ushqejnë lidhjen e tij me idetë ekstremiste.

» Trauma dhe mekanizma të tjerë nxitës

Këtu përfshihen traumat psikologjike të përjetuara në fëmijëri, që janë manifestuar tek individit në formën e çrregullimit të stresit post-traumatik (PTSD), por mund përfshihen edhe probleme të tjera komplekse të lidhura me shëndetin mendor.

» Dinamika e grupit

Normat e grupit janë burim i fuqishëm influence për antarët e grupeve specifike. Individët mund të zgjedhin një rrugë që nuk e kishin konsideruar më parë pikërisht për shkak të ndikimit të dinamikës së grupit. Prandaj, ekstremizmi i dhunshëm mund të shfaqet lehtësisht në grupe të bashkuara nën një ideologji të përbashkët.

» Media sociale

Aktualisht media sociale është platforma më e përshtatshme për shpërndarjen e informacionit në formatin e dëshiruar dhe në mënyrën më të shpejtë të mundshme. Mediat sociale shumëfishojnë lehtësisht gjuhën e urrejtjes dhe riorganizojnë përhapjen e informacionit të rremë. Ka një sërë aplikacionesh celulari dhe/ ose faqe/kanale që mund të përdoren lehtësisht për të kontaktuar individë të ndryshëm, për të ndikuar gjendjen e tyre emocionale dhe psikologjike dhe për të nxitur të bashkohen me grupet e ekstremizimit të dhunshëm. Në shumicën e rasteve në mediat sociale është e vështirë të bësh dallimin midis lajmeve të vërteta dhe atyre të rreme, prandaj mundësitë që individët të ndikohen janë mjaft të larta.



Kategorizimi i “barometrit të sjelljes”, është një udhëzues për vlerësimin e sjelljeve që mund të shërbejnë si tregues të procesit të ekstremizimit të dhunshëm. Këtu dallohet qartë, në një rën anë, aktivizimi jo i dhunshëm dhe demokratik dhe, nga ana tjetër, sjellja ekstremiste që evidenton me fjalë ose veprime gatishmërinë për të përdorur dhunën.

Shenjat dhe sjelljet paralajmëruese të ekstremizimit të të rinjve

SJELLJE TË PARËNDËSISHME

Kjo kategori përfshin një sërë sjelljesh të lidhura me forma të ndryshme të angazhimit politik, fetar ose komunitar, të cilat karakterizohen nga veprime paqësore dhe me mjete demokratike të të shprehurit.

- Argumentim i zjarrtë për të mbrojtur bindjet para anëtarëve të familjes dhe/ose miqve të ngushtë.
- Adaptim i shenjave të dukshme (rrobat tradicionale, mjekra, kokën e rruajtur, simbole fetare, tatuazhet specifike, etj.) për të shprehur identitetin e tyre.
- Aktivizim në mediat sociale.
- Adaptim qëndrimesh dhe pjesëmarrje në fushata në mënyrë paqësore për një shkak që lidhet me një komunitet, një grup ose një individ.
- Interesim i madh për çështjet aktuale kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Dëshirë për të ri-integruar ose për të rritur përfshirjen në një praktikë fetare, ose një identitet apo angazhim politik.
- Konvertim ose miratim ndaj besimeve të reja fetare, ideologjike ose politike.
- Këmbëngulje për të ndjekur kërkesat specifike dietetike për shkak të bindjeve politike ose fetare.
- Dëshirë për t'i dhënë zgjidhje padrejtësive sociale.

SJELLJE SHQETËSUESE

Kjo kategori përfshin sjelljet që tregojnë probleme të funksionimit normal të individit.

Këtu gjithashtu përfshihen sjelljet që përfaqësojnë një vetëidentifikim gjithnjë e më të madh me një shkak apo ideologji që e udhëheq individin të ndryshojë ndjeshëm sjelljen e tij.

- Shfaqje të pikëpamjeve polarizuese mbi të vërteta absolute, paranoja ose mosbesimit ekstrem.
- Miratimi i sjelljeve që krijon shkatërrime me praktikën familjare.
- Tërheqje ndaj teorive dhe diskutimeve kospitacioniste.
- Izolim i vetes nga familja dhe / ose miqtë.
- Ndryshim i pa prituri i zakoneve.
- Paraqitje me këmbëngulje e ideve fetare dhe ideologjike për njerëzit e tjerë.
- Refuzim i rregullave dhe rregulloreve në institucionet dhe organizatat e kontaktit (shkolla, vendi i punës, klubet sportive, etj.) bazuar në baza ideologjike, politike ose fetare.
- Refuzim për të marrë pjesë në aktivitetet e grupit ose për të qëndruar në kontakt me individë të caktuar për shkak të fesë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë apo orientimit seksual të këtij të fundit.
- Ndjenja viktimizimi dhe refuzimi.
- Shprehje të nevojës për të dominuar ose kontrolluar të tjerët.
- Vështirësi në rivlerësimin e ideve dhe / ose në njohjen e vlerës tek pikëpamjet e tjera.

SJELLJE KËRCËNUESE

Kjo kategori përfshin sjelljet që mund të lidhen me fillimin e angazhimit të një individ në një trajektore radikale. Ato karakterizohet nga një mosbesim i fortë ndaj botës së jashtme dhe nga një mbizotërim i pikëpamjeve që legjitimojnë përdorimin e dhunës për të arritur qëllimet, ose për të fituar kauzën.

- Ndërprerje e lidhjeve me anëtarët e familjes dhe / ose me miqtë e ngushtë me qëllim mbajtjen e shoqërive ekskluzive me një rreth tëri të njohurish ose miqsh.
- Legjitimimi i përdorimit të dhunës për të mbrojtur një kauzë apo ideologji.
- Fshehja e një mënyre jetese të re, besnikërie ose besimi ndaj anëtarëve të familjes dhe / ose miqve të ngushtë (qoftë online ose në jetën reale).
- Afërsi ndaj individëve ose grupeve të njohura si ekstremiste të dhunshme.
- Pakënaqësi e papritur ndaj aktiviteteve profesionale ose shkollore.
- Shfaqje e simboleve të përkatësisë ose mbështetjes që lidhet me grupe të njohura si ekstremiste të dhunshme.
- Fiksuar me ide për fundin e botës.
- Shprehje e pikëpamjeve të urrejtjes ndaj individëve ose grupeve të tjera.

SJELLJE ALARMANTE

Kjo kategori përfshin një sërë sjelljesh që tregojnë dëshmi të një besnikërie ekskluzive dhe sekrete ndaj një ideologjie ose një kauze, e cila e çon individin ta perceptojë dhunën si mjetin e vetëm legjitim dhe të vlefshëm të veprimit.

- Pjesëmarrje në aktivitete të grupeve ekstremiste të dhunshme me çdo mjet të mundshëm (material, financiar ose fizik).
- Rekrutim i individëve për çështje të dhunës ekstreme (ose inkurajim për t'u regjistruar për këtë arsye).
- Kontakte me një grup ose një rrjet individësh të njohur si radikal të dhunshme, qoftë online ose ballë për ballë.
- Përforsim i besimeve përmes konsultimeve të rregullta të forumeve dhe faqeve të internetit të dhunës ekstreme.
- Kryerja ose planifikimi i veprime të dhunshme ose urrejtjes të frymëzuara nga motive ideologjike.
- Të mësuarit rreth, të kërkuarit për të ditur sesi përdoren armët (armë zjarri, eksplozivë, etj.) përtej kufizimeve ligjore.

EDUKIMI I TË RINJVE STRATEGJI PARANDALUESE KUNDËR EKSTREMIZIMIT TË DHUNSHËM

Ambjente shkollore të sigurta dhe mbështetëse

Pas familjes, për fëmijët dhe të rinjtë shkolla është një nga mjediset sociale më të rëndësishme. Është vendi ku ata mësojnë se si të shohin dhe të ndërveprojnë me anëtarët e tjerë të shoqërisë, të luftojnë me mënyrën se si shoqëria i trajton dhe të komunikojnë me bashkëmoshatarët.

Kjo është arsyeja pse është thelbësore që shkollat të jenë mjedise mësimore të sigurta dhe mbështetëse. Fatkeqësisht, për shumë fëmijë ato mund të jenë mjedisi i parë shoqëror ku ata janë objektivi i sjelljeve agresive, dhe/ose ku ata fitojnë modele sjelljeje që hedhin poshtë të kuptuarit e tyre njohës se përdorimi i dhunës është i gabuar. Në këto kushte, shkollat bëhen vendi ku nxënësit zhvillojnë ose përforcojnë ndjenjat e përjashtimit dhe intolerancës.

Në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet edukimit, asgjë nuk është më e rëndësishme sesa kthimi i mjediseve arsimore në ambjente fuqizuese, për të siguruar që të gjithë nxënësit, pa dallime gjine, të përjetojnë dhe të mësojnë së pari se si të jetojnë së bashku në paqe.

Zero tolerancë ndaj dhunës

Faktorë të shumtë e formësojnë shfaqjen e dhunës në shkolla të tilla si: modeli familjar i nxënësit, mjedisi i jashtëm i shkollës, kuptimi kulturor i shoqërisë për dhunën, faktorët socio-ekonomikë etj. Ka shumë dallime midis kulturave, shoqërive dhe sistemeve të tyre ligjore në përcaktimin e asaj që përbën një akt apo mjedis të dhunshëm. Megjithatë, përgjithësisht kuptohet se dhuna ndodh në forma sociale, fizike dhe psikologjike dhe përfshin akte të tilla si ndëshkimi trupor dhe psikologjik, ngacmimi, dhuna seksuale dhe ajo me bazë gjinore etj. Mund të kryhet gjithashtu nga mësues dhe anëtarë të tjerë të stafit të shkollës dhe /ose nga bashkëmoshatarët e nxënësve. Ajo që është e shqetësuese në lidhje me këto forma të dhunës në kontekstin e mjediseve shkollore, përtej ndikimit të tyre shkatërrues mbi viktimat, është morali i përgjithshëm që përhapet në një institucion kur dhuna pranohet si një mjet normal për zgjidhjen e problemeve. Për të eliminuar këtë besim të heshtur por të dëmshëm, shkolla duhet të miratojë një politikë të qartë "Zero Tolerancë ndaj dhunës".

Megjithëse kjo politikë mund të mos i japë fund dhunës menjëherë, ajo është efektive në dërgimin e një kundërmesazhi të qartë se institucioni dhe të gjithë anëtarët e tij janë të bashkuar në angazhimin për të mos toleruar asnjë formë dhune.

Ky është një nga qëllimet e miratimit të Kodeve të Sjelljes në shkolla për mësuesit dhe nxënësit me qëllim vendosjen e normës dhe papranueshmërinë e sjelljeve të dhunshme në shkollë.

Edukimi i të rinjve mbi vlerat dhe të drejtat themelore të njeriut

Edukimi në vetvete nuk mund të parandalojë një individ nga kryerja e një akti të dhunshëm në emër të një ideologjie ekstremiste, por ofrimi i një arsimimi cilësor mund të ndihmojë në krijimin e kushteve që të rinjtë të dinë të mbrojnë veten nga ndikimi i ideologjive dhe akteve të dhunshme ekstremiste.

Për këtë arsye, politikat dhe praktikat arsimore duhet, drejtpërdrejt dhe tërthorazi, të adresojnë nxitësit specifikë të ekstremizmit të dhunshëm duke qënë sa më gjithëpërfshirëse dhe të barabarta për ti parë dallimet individuale midis nxënësve jo si probleme për t'u rregulluar, por si mundësi për të pasuruar të mësuarit.

Konkretisht edukimi mund t'i ndihmojë të rinjtë:

- Të zhvillojnë aftësitë e komunikimit dhe ato ndërpersonale që u nevojiten për të dialoguar, për t'u përballur me mosmarrëveshjet dhe të mësojnë qasjet paqësore reagimi në të tilla rrethana;
- Të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik, për të shqyrtuar pretendimet, për të qartësuar thashethemet dhe për të vënë në pikëpyetje legjitimitetin dhe kërkesat për besime ekstremiste;
- Të zhvillojnë aftësi për t'iu rezistuar ideve e qëndrimeve ekstremiste dhe për të përfutur aftësitë social-emocionale që ju duhen, për të kapërcyer dyshimet që kanë dhe për t'u angazhuar në mënyrë konstruktive në shoqëri, pa qenë nevoja për t'iu drejtuar dhunës;
- Të formojë qytetarë të informuar, të aftë për të marrë pjesë në aktiviteteve kolektive paqësore.

Ekstremizmi i dhunshëm ndikon dukshëm mirëqenien, dinjitetin dhe sigurinë e individëve dhe të shoqërive në tërësi. Në këto kushte, zbatimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut kthehet në prioritet duke synuar që paralelisht me sigurinë të identifikohen shkaqet rrënjësore të fenomenit. Çdo hap kundër ekstremizmit të dhunshëm duhet të bazohet në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe duhet të kryhet në mënyrë të tillë që të mos lejojë as shënjestrimin e individëve apo grupeve të veçanta, as shkeljen e të drejtave dhe lirive të tyre themelore.

Të rinjtë konsiderohen si një prej target grupeve më të rrezikuar për të rënë pre e narrativave ekstremiste që promovohen përmes platformave online pasi ata janë përdoruesit më aktivë të këtyre mediave. Edhe në këtë fushë, arsimi është një instrument i rëndësishëm që mund të përdoret për të arritur tek të rinjtë dhe për të kundërshtuar narrativat e ekstremizmit të dhunshëm përmes të menduarit kritik të informacionit që ju serviret nga media.

Edhe pse e drejta për arsim njihet si një nga të drejta themelore të njeriut nga shumë konventa ndërkombëtare dhe është një nga qëllimet kryesore të Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit të zhvilluara nga vendet e OKB-së, shumë fëmijë dhe të rinj ende përballen me një sërë vështirësish në rrugën e tyre drejt një arsimit cilësor.

Roli i mësuesve

Mësuesit mund të luajnë një rol qendror në parandalimin të ekstremizmit të dhunshëm. Duke qënë në kontakt të drejtpërdrejtë me të rinjtë, ata mund të jenë modele, agjentë ndryshimi dhe ndërmjetës, duke i orinetuar të rinjtë drejt dialogut dhe respektit reciprok. Ata gjithashtu mund të jenë të parët që identifikojnë shenjat e ekstremizimit dhe të përpiqen ti zbutin ato përmes eksplorimit dhe diskutimeve të hapura.

Mësuesit mund të shërbejnë si një urë lidhëse midis shkollës, familjeve dhe komunitetit më të gjerë për të siguruar që të gjithë palët e interesuara po punojnë drejt një qëllimi të përbashkët për të mbështetur dhe ndihmuar të rinjtë në rrezik.

Për t'i lejuar mësuesit të luajnë një rol të tillë konstruktiv si ndërmjetës të paqes, ata duhet të konsultohen, motivohen dhe të pajisen me mjetet e duhura të mësimdhënies. Kjo përfshin zhvillimin e kompetencave për të nxitur tek nxënësit e tyre një sërë aftësish njohëse dhe jo njohëse - të tilla si të menduarit kritik, guximi, morali dhe sjellja e përgjegjshme etj.

Mësuesit gjithashtu duhet të inkurajohen të jenë të respektueshëm dhe të vëmendshëm ndaj sfidave personale të nxënësve ndërsa ata luftojnë me çështje të identitetit dhe kuptimit të vetes. Ky dimension nuk duhet të anashkalohe nëse mësuesit duan t'u ofrojnë nxënësve udhëzimet e duhura për t'iu ndihmuar ti qëndrojnë larg veprimeve të lidhura me ekstremizimin e dhunshëm. Mësuesve duhet t'u jepet mbështetja e duhur psikologjike dhe sociale për të përballuar dhe kapërcyer sfidat e lidhura me rolin e tyre konstruktiv në parandalimin e ekstremizimit të dhunshëm.



SHEMBULL

Denisi ishte 12 vjeç kur familja e tij vendosi që duhet të linin fshatin e vogel ku jetonin për t'u zhvendosur në Tiranë. Ditën e parë që Denisi shkoi në shkollën e re u ndje i bullizuar nga shokët e klasës. Ata e shikonin me përbuzje dhe përdornin shprehje të ndryshme ofenduese ndaj tij. Denisi filloi të mbyllej në vetvete, duke refuzuar të bisedonte për këtë çështje edhe me prindërit. Mësuesi kujdestar i Denisit duke e parë gjithmonë të veçuar nga bashkëmoshatarët filloi të shqetësohej për sjelljen e tij. Së pari vendosi të referonte problematikat që kishte vënë re te Denisi të stafi psiko-social i shkollës. Kështu, me miratimin e prindërve Denisi filloi të merrte këshillim individual. Paralelisht u punua me edhe me shokët dhe shoqet e klasës së Denisit. Me anë të serie aktiviteteve praktike u punua për të promovuar në mjedisin e klasës tolerancën dhe diversitetin, duke ju theksuar nxënësve që janë pikërisht karakteristikat e tyre individuale që i bëjnë “unik” dhe jo “të ndryshëm” në mënyrë negative.



PËR T'U MBAJTUR MEND

» Çdo nxënës ka nevojat e tij/ saj individuale dhe mënyra e ndërveprimit me ta duhet të marrë në konsideratë këto nevoja.

» Mësuesi duhet t'i ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të marrëvendimet e duhura në faza të ndryshme të jetës së tyre.

» Asnjë nxënës nuk është i imunizuar nga ndikimi i ideologjive radikale dhe të dhunshme.

» Nevojitet ndërhyrje gjithëpërfshirëse për të mbajtur të rinjtë të sigurt dhe larg këtyre dukurive.

MBËSHTETJE PËR FËMIJËT DHE TË RINJTË E RIKTHYER NGA ZONAT E KONFLIKTIT

RIINTEGRIMI SOCIAL I FËMIJËVE DHE TË RINJVE

Fëmijët dhe të rinjtë e rikthyer nga zonat e konfliktit kërkojnë kujdes dhe mbështetje të veçantë për t'u riintegruar në mënyrë efektive dhe për t'u bërë anëtarë konstruktivë të shoqërisë. Këta fëmijë mund të kenë qënë të ekspozuar ndaj dhunës ekstreme dhe pas rikthimit mund të përballen me një refuzim dhe stigmatizim të ashpër brenda komuniteteve të tyre.

Riintegrimi social mund të përkufizohet si çdo ndërhyrje që synon të mbështesë fëmijët e rikthyer nga zonat e konfliktit për t'u integruar me sukses në komunitet, duke përfshirë adresimin e aspekteve ekonomik, social dhe psikologjik.

Ky përkufizim nxjerr në pah dy komponentë kyç të proceseve të riintegrit. E para, ka të bëjë me rehabilitimin individual të fëmijës dhe adreson nevojat e tij/saj specifike. E dyta, fokusohet në rivendosjen ose krijimin e lidhjes ndërmjet fëmijës dhe mjedisit social, dhe në këtë mënyrë kërkon që të merren parasysh edhe nevojat e familjeve dhe komuniteteve.

Për të qënë gjithëpërfshirëse dhe efektive, programet e riintegrit duhet të marrin parasysh situatën personale të fëmijës, dhe në të njëjtën kohë të përshtaten me kontekstin dhe shoqërinë në të cilën fëmija duhet të rimarrë një rol aktiv.

Fëmijët e rikthyer nga zonat e konfliktit, mund të kenë pësuar lëndime fizike ose të kenë vuajtur nga sëmundje akute ose kronike, të cilat mund të jenë lënë të patrajtuara dhe si rezultat kanë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin dhe riintegrimin e tyre.

Referuar studimit të Save the Children 2019[4] fëmijët e rikthyer nga zonat e konfliktit mund të shfaqin çrregullime të ndryshme të shëndetit mendor të tilla si çrregullime të stresit post-traumatik (PTSD), depresion etj. dhe mos trajtimi i tyre në mënyrën e duhur ka të ngjarë të dëmtojë aftësinë e fëmijës për të ngrënë, për të fjetur, për t'u përqëndruar dhe për të mësuar.

Studimi tregon gjithashtu se gjinia ka një ndikim të rëndësishëm në reagimin ndaj ngjarjeve jashtëzakonisht të dhunshme dhe në veçanti vajzat kanë shanse më të larta për të zhvilluar çrregullime të stresit post-traumatik, i cili mund të shoqërohet jo vetëm me ekspozim më të fortë ndaj ngjarjeve traumatike, por edhe me akses më të kufizuar ndaj trajtimit. Aksesit në shërbime psiko-sociale është një pjesë e rëndësishme e rehabilitimit dhe riintegrit të këtyre fëmijëve në shoqëri.

[4] Save the Children (2019). Road to Recovery: Responding to children's mental health in conflict. E aksesueshme online në: <https://resourcecentre.savethechildren.net/document/road-recovery-responding-childrens-mental-health-conflict>

MBËSHTETJE PËR FËMIJËT DHE TË RINJTË E RIKTHYER NGA ZONAT E KONFLIKTIT

RIKTHIMI I FËMIJËVE/ TË RINJVE TË RIKTHYERNË AMBJENTET SHKOLLORE

Rikthimi i fëmijëve dhe të rinjve të rikthyer nga zonat e konfliktit në sistemin (para) shkollor ka një rëndësi thelbësore në procesin e tyre të rehabilitimit dhe riintegritimit. Ky rikthim ju krijon fëmijëve dhe të rinjve një ndjenjë sigurie, normalizon jetën e tyre të përditshme, ju mundëson ekspozimin ndaj kulturës së diversitetit dhe rrit ndëreveprimin me individë jashtë familjes. Por përpara se fëmija të rikthehet në mjediset shkollore, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve në bashkëpunim me stafin e shërbimit psiko-social të shkollës duhet të kryejnë një vlerësim rreziku dhe nevojash të fëmijës.

» Normalizimi si parim udhëzues: Parimi kryesor, kur kemi të bëjmë me fëmijët dhe të rinjtë e rikthyer në mjediset arsimore, është 'rikthimi në normalitet' sa më shpejt të jetë e mundur. Shkollat duhet të ofrojnë një hapësirë të sigurt ku fëmija ose i riu/ e reja të ndihet i mbështetur. Rreziku që është nxënësi të shihet si "ndryshe" duhet të minimizohet dhe duhet të bëhen përpjekjet e duhura për të minimizuar vëmendjen ndaj tij/ saj.

» Ballafaqimi me rreziqet e mundshme të lidhura me fëmijët apo të rinjtë e rikthyer: Për shkak të historisë së tyre dhe përvojave personale, mund të ketë shqetësime se fëmijët e rikthyer paraqesin rrezik për fëmijët e tjerë në shkollë. Ky shqetësim duhet të adresohet duke ndërgjegjësuar mësuesit mbi reagimet e mundshme të lidhura me traumën e këtyre fëmijëve dhe mënyrat e duhura të adresimit të këtyre sjelljeve.

» Shkollat duhet t'i inkurajojnë fëmijët të zhvillojnë ide dhe përgjegjësi: Fëmijët duhet të mbështeten të bëhen anëtarë pozitivë të komunitetit të shkollës dhe t'ju jepjen mundësi për të qenë të suksesshëm. Ky është një aspekt shumë i rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të personalitetit të këtyre fëmijëve.

» Ofroni një periudhë të ndërmjetme ripërshtatjeje për fëmijën: Kjo mund ta ndihmojë fëmijën të ambjentohet brenda ambjentit shkollor (pas një periudhe të caktuar shkëputje dhe jetese në një mjedis krejtësisht të ndryshëm). Kjo periudhë rekomandohet të jetë sa më e shkurtër. Gjatë kësaj kohe i kushtohet vecanerisht vëmendje ndërtimit të besimit me fëmijën dhe vlerësimit të nevojave të tij.

MBËSHTETJE PËR FËMIJËT DHE TË RINJTË E RIKTHYER NGA ZONAT E KONFLIKTIT

» Shkolla duhet t'i kushtojë rëndësi progresit të fëmijës: Drejtoria e shkollës duhet të sigurohet që fëmijës së rikthyer po i kushtohet vëmendja e duhur dhe të kenë informacion të vazhdueshëm për aktivitetet dhe progresin e tij. E këshillueshme është që një anëtar i stafit pedagogjik të caktohet për ta monitoruar fëmijën nga afër (mund të jetë mësuesi kujdestar, punonjësi i shërbimit psiko-social etj).

» Zhvillimi i një strukture mbështetëse për shkollën: Në bashkëpunimin me partnerë të tjerë publikë ose jopublik, shkollat mund të krijojnë struktura mbështetëse me profesionistë të fushave të ndryshme të cilët mund të japin kontributin e tyre në propozimin dhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme që inkurajojnë integrimin e fëmijëve të rikthyer në ambjentet shkollore.

» Programe speciale për fëmijët e rikthyer: Si për çdo çështje tjetër të ndjeshme që përfshin fëmijët, të rinjtë apo fëmijët e rikthyer nuk duhet të izoloohen ose të identifikohen për trajtim "të veçantë". Megjithatë, kjo nuk e mohon nevojën për programe mbështetëse individuale të përshtatura për nevojat e tyre specifike (p.sh vështirësia që fëmija mund të ketë më lëndë specifike shkollore).

» Akses në ekspertizë për ekstremizmin e dhunshëm: Edhe pse në përgjithësi stafi i shkollës është i trajnuar për t'u marrë me fëmijët vulnerabël, disa trajnime shtesë mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe rrethanat në të cilat fëmijët e rikthyer kanë jetuar apo traumat që ata mund të kenë përjetuar është këshillueshme të ofrohen. Stafi i Qendrës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm mund tju japë mbështetjen e duhur në këtë aspekt.



Informacion

ROLI KOORDINUES DHE MONITORUES I QENDRËS SË KOORDINIMIT KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 737, datë 13.12.2017 “Për ngritjen e Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH)” si rezultat i një sërë masash të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare për të trajtuar shfaqjen e Ekstremizmit të Dhunshëm te shtetasit shqiptarë që u bashkuan në radhët e organizatave ekstremiste në konfliktet në Lindjen e Mesme vitet e fundit, duke përfshirë të ashtuquajturin Shtet Islamik në Siri dhe Irak (ISIS). Në vitin 2015, Qeveria Shqiptare zhvilloi dhe miratoi Strategjinë Kombëtare Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, sipas një vendimi të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit”, Nr. 930, i cili parashikon përfshirjen e aktorëve kryesorë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, duke promovuar vlerat demokratike dhe adresimin e atyre shqetësimeve në nivel lokal që mund të nxisin radikalizimin.

Pas miratimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Këshilli i Ministrave krijoi njëkohësisht Qendrën për Koordinimin Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri, si një qendër për koordinimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të aktorëve lokalë dhe praktikuesve të vijës së parë, të përfshirë në përpjekjet për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri dhe rajon, duke ndarë praktikat më të mira dhe duke zhvilluar masa të bazuara në dëshmi efektive për të luftuar kërcënimet nga ekstremizmi i dhunshëm. QKEDH-ja, si institucion shtetëror përgjegjës për hartimin e politikave, koordinimin dhe iniciativat e aktiviteteve me aktorët shtetëror dhe jo-shtetëror, vendas e të huaj, nëpërmjet prezantimit të saj dhe arritjeve në nivel rajonal dhe ndërkombëtar në parandalimin e luftimit e fenomeneve të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në vend, e cila luan një rol të patjetërsueshëm në sigurinë e vendit.

Informacion

ROLI KOORDINUES DHE MONITORUES I QENDRËS SË KOORDINIMIT KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Disa nga objektivat e funksionimit të Qendrës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm janë:

Ø forcimi i koordinimit institucional, bashkëpunimit dhe partneritetit në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, ndërmjet agjencive qeveritare, organizatave joqeveritare, sektorit privat, komuniteteve fetare dhe mediave, në identifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve efektive;

Ø monitorimi dhe zbatimi i programeve të rehabilitimit dhe ri-integrimit me qëllim koordinimin në nivel kombëtar duke respektuar parimin e ligjshmërisë, respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, paanësisë, përgjegjshmërisë, profesionalizmit, ruajtja e të dhënave konfidenciale, mosdiskriminimit, kontrollit dhe llogaridhënies, duke bërë që ky proces të jetë efektiv në mekanizmin e funksionimit gjithëpërfshirës me institucionet e linjës;

Ø inkurajimi i hulumtimit vendor si mjet për të kuptuar kushtet, faktorët dhe shkaqet që nxisin radikalizimin që mund të kalojë në dhunë dhe qëndresën e komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm; forcimi i qëndresës së komunitetit dhe zvogëlimi i tërheqjes ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet programeve dhe politikave të arsimit, punësimit dhe parandalimit nga policia në komunitet;

Ø ulja e ndikimit të propagandës ekstremiste në rrjetet sociale dhe rekrutimit në internet, duke shfrytëzuar mediat sociale si kanale të komunikimit për të promovuar narrativa alternative dhe mesazhe pozitive.

Roli dhe pozicionimi i QKEDH-së, në kuadër të përgjegjësisë që i ngarkohen me ligj, për evidentimin, sinjalizimin, apo parandalimin e rasteve të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në vend, si dhe programet e rehabilitimit dhe ri-integrimit, por dhe zbatimit të programeve të punës që burojnë nga Strategjia Kombëtare, është i qëndrueshëm dhe i pandryshueshëm, si një kupolë koordinuese me ministritë e linjës dhe aktorët e tjerë të përfshirë në këtë proces duke promovuar vlerat e tolerancës dhe harmonisë fetare, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sundimin e ligjit dhe demokracisë, si dhe mbrojtjen e shoqërisë shqiptare nga ekstremizmi i dhunshëm.

Për më shumë informacion vizioni faqen e tyre të website: www.cve.gov.al

REFERENCA

- 1.ERYICA (2018). Liaisons a toolkit for preventing violent extremists through youth information. E aksesueshme online në: <https://rm.coe.int/liaisons-english/1680a2a1b6>
- 2.Georgian Center for Strategy and Development (2019). Manual for Civic Education Teachers: Prevention of Violent Extremism and Radicalication. E aksesueshme online në: <https://gcsd.org.ge/storage/files/doc/Manual%20for%20Civic%20Education%20Teachers.pdf>
- 3.OSCE (2013). Youth Engagement to Counter Violent Extremism and Radicalization that lead to Terrorism - Report on findings and Recommendations. E aksesueshme online në: <https://www.osce.org/files/f/documents/c/b/103352.pdf>
- 4.OSCE (2020). Rehabilitimi dhe riintegrimi jashtë kontekstit të burgut për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizimit të dhunshëm dhe radikalizimit që cojnë në terrorizëm – Udhëzësues për politikëbërësit dhe ofruesit e shërbimneve në Evropën Juglindore. E aksesueshme online në: <https://www.osce.org/files/f/documents/b/0/467055.pdf>
- 5.RAN Center of Excellence (2017). Responses to returnees: Foreign Terrorist fighters and their families. E aksesueshme online në: https://ec.europa.eu/home-affairs/system/files/2020-09/ran_br_a4_m10_en.pdf
- 6.Salto - Youth Cultural Diversity Resource Center (2017). Young People and extremism: a resource pack for youth workers. E aksesueshme online në: <https://www.salto-youth.net/downloads/4-173477/SALTO%20extremism%20pack.pdf>
- 7.Save the Children (2019). Road to Recovery: Responding to children's mental health in conflict. E aksesueshme online në: <https://resourcecentre.savethechildren.net/document/road-recovery-responding-childrens-mental-health-conflict>
- 8.Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizimit të Dhunshëm, Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve dhe Save the Children (2020). Broshurë informuese për nxënësit “Radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm -Si mund të flasin nxënësit?”. E aksesueshme online në:https://cve.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/Broshure-per-femijet_Save-the-Children_Alba.pdf
- 9.Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizimit të Dhunshëm, Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve dhe Save the Children (2020). Broshurë informuese për mësuesit “Mësuesi dhe shkolla aktorët kryesorë në parandalimin e ekstremizimit të dhunshëm”. E aksesueshme online në:https://cve.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/Broshure-per-mesues_Save-the-Childre_alb.pdf
- 10.UNESCO (2016). A teacher's Guide on the Prevention of Violent Extremism. E aksesueshme online në: https://en.unesco.org/sites/default/files/lala_0.pdf
11. UNESCO (2017). Preventing violent extremism through education – A guide for Policy -makers. E aksesueshme online në: <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000247764>
12. UNDP (2016). Preventing Violent EXTREMISM THROUGH PROMOTING INCLUSIVE DEVELOPMENT, TOLERANCE AND RESPECT FOR DIVERSTIY – A development response to addressing radicalization and violent extremism. E aksesueshme online në: [file:///C:/Users/user/Downloads/Discussion%20Paper%20%20Preventing%20Violent%20Extremism%20by%20Promotin%20Inclusive%20%20Development%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/user/Downloads/Discussion%20Paper%20%20Preventing%20Violent%20Extremism%20by%20Promotin%20Inclusive%20%20Development%20(1).pdf)
13. Vrugtman, L. et al (2021). Ekstremizimi I Dhunshëm në Shqipëri – Vlerësim Kombëtar i nxitësve, formave dhe rreziqeve. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. E aksesueshme online në: https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Ekstremizmi-i-Dhunshem_AL-2021-online.pdf

Ky manual është realizuar fal mbështetjes së Global Community Engagement and Resilience Fund (GCERF).

Manuali është hartuar nga ekspertë të Institutit Adriapol, në kuadër të projektit "Parandalimi dhe riintegrimi i sigurt: Një qasje holistike dhe qëndrueshme ndaj ekstremizmit të dhunshëm" zbatuar nga Instituti Adriapol me partner Terre Des Hommes Shqipëri dhe Qendrën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri (CVE).